



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 nënparagrafi 8.1.2 të Rregullave (F03) për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteteve kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të miratuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “VLERA” SH.P.K. të datës 22.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi I institucioneve edukative arsimore” me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Vlera” SH.P.K. e datës 22.03.2023 kundër njoftimit për kontratë të autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 02.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi I institucioneve edukative arsimore” me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1
- II. **KORIGJOHET** njoftimi për kontratë i autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 02.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi I institucioneve edukative arsimore” me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1
- III. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës që të bëjë zgajtjen e afatit të dorezimit të ofertave për të paktën 10 ditë prej datës së këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHET** menjëherë operatori ekonomik “VLERA” SH.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim, përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik " VLERA" SH.P.K (tutje si "parashtruesi") me datë 21.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 02.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi I institucioneve edukative arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1. Pretendimet e parashtruesit janë lidhur me specifikimet teknike të paisjeve për dezinfektim, saktësisht OE kërkon që mos të kërkohej që paisja të ketë pershkrimin që duhet të liroje avull në temperaturë 120 grad celcius sepse shumë kompani që prodhojnë ULV në specifikacionin e tyre nuk ceket ky parameter.


Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 22.03.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim. Me këtë rast është arritur konstatimi se "Pretendimi i parashtruesit se nuk ka nevojë të ceket temperatura 120 grad celcius sepse shumë kompani që prodhojnë ULV në specifikacionin e tyre nuk ceket ky parameter kur dihet shkencërisht që temperatura e avullit është mbi 120 OC dhe mund të rritet varesisht prej presionit (bar) të makinerisë është pretendim i saktë".

Në përputhje me konstatimet si më sipër, autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës duke u bazuar në parimet e përgjithshme të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik përkatësisht në nenin 7 lidhur me barazinë në trajtim, jo-diskriminimin dhe transparencën, do të bëjë korigjim të njoftimit për kontratë.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.03.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.